

VENDIM
Nr.360, datë 4.5.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.311, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË AKOMODIMIT TË
PËRKOHSHËM TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN SI REZULTAT I
GJENDJES SË SHKAKTUAR NGA COVID-19”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1, të vendimit nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Përfundimisht nga sa parashikohet në këtë vendim, akomodimi dhe/ose vetëkarantinimi i personave që riatdheshen mund të bëhet edhe në banesat e tyre. Rregullat më të hollësishme mbi rastet përjashtimore të akomodimit/vetëkarantinimit përcaktohen me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama